

VENDIM
Nr. 74, datë 16.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 16.6.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 18 (D) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Dritan Zagani, përfaqësuar nga avokati Dorian Matlija, me prokurë përfaqësimi.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Isa Jata, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 62-2018-6117 (467), datë 19.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 142, datë 4.6.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-277, datë 18.2.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së nenit 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rimbursimi i shpenzimeve të përfaqësimit përpara Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 7, 10, 13 dhe 18, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 47 dhe 49, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Dritan Zagani (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është proceduar, në kuadër të një procedimi penal të vitit 2013, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 300 të Kodit Penal (*KP*). Ai është arrestuar në datën 3.5.2014 dhe ndaj tij është zbatuar masa e sigurimit

personal e arrestit në burg deri në datën 8.11.2014, kur është zëvendësuar me masën e sigurimit personal të arrestit në shtëpi. Ndërsa në datën 12.11.2014, kërkuesit i është komunikuar akuza dhe çështja është dërguar për gjyq.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin e datës 16.2.2015, ka vendosur ndarjen e çështjes penale në ngarkim të kërkuesit, shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 300 të KP-së.

3. Ndërkohë, në datën 1.9.2015, është konstatuar se kërkuesi ishte larguar nga banesa. Lidhur me këtë ngjarje, e cila është shqyrtuar veçmas nga procedimi penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 300 të KP-së, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 61-2016-5131, datë 27.12.2016, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale të largimit nga vendi i qëndrimit të detyruar, të parashikuar nga neni 323, paragrafi i parë, i KP-së dhe e ka dënuar atë me 3 vjet burgim.

4. Për sa i takon procedimit penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 300 të KP-së, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2018-6117 (467), datë 19.11.2018, ka vendosur, ndër të tjera, deklarimin fajtor të kërkuesit sipas akuzave (nenet 248 dhe 300 të KP-së) dhe e ka dënuar atë me 4 vjet e 6 muaj burgim, si dhe heqjen e së drejtës për ushtrimin e funksioneve publike për një periudhë prej 2 vjetësh, me arsyetimin se, nga ana objektive dhe subjektive, ai ka konsumuar veprat penale, për të cilat është akuzuar.

5. Për ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 142, datë 4.6.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-277, datë 18.2.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të tij.

6. Në datën 1.8.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Me vendimin e datës 11.11.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e gjykatave të zakonshme i kanë cenuar:

7.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1.1 *Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, pasi për procedimin ekzistojnë dyshime serioze për motive politike dhe manipulim procedural që ndërthuren me veprimet e kërkuesit për denoncimin publikisht të lidhjeve të ministrit të Brendshëm me një grup kriminal. Ndonëse ai ka kërkuar verifikimin e presionit politik, asnjë prej gjykatave nuk ka thirrur dëshmitarë për të hedhur dritë mbi rrethanat e arrestimit dhe të deklaratave publike, por ato janë mjaftuar me vlerësimin që ato ishin pa relevancë, duke i lënë dyshimet pa përgjigje. Përfitimi i azilit politik në Zvicër forcon tezën se edhe një shtet i tretë ka arritur në përfundimin se procedurat penale nuk i kanë garantuar atij gjykimin e paanshëm dhe mbrojtjen efektive. Ndaj tij nuk është zhvilluar një hetim i plotë dhe i gjithanshëm dhe gjykatat e faktit kanë pranuar akuzën sikurse është paraqitur, kurse Gjykata e Lartë nuk e ka trajtuar pretendimin për hetim selektiv dhe represion institucional. Ai ka sjellë një sërë provash që nëse do të vlerësoheshin në mënyrë të

paanshme do të rrëzonin premisën e fajësisë. Raportet zyrtare kanë treguar raportimin e menjëhershëm tek eprorët, rolin e tre drejtuesve dhe mungesën e pasojave.

7.1.2 Parimit të barazisë së armëve, pasi akuza u lejua të mbështetej në hipoteza, ndërsa mbrojtjes i është mohuar forma shfajësuese e provave të saj. Kjo gjë ka sjellë mungesë të kontrollit substancial, sepse provat dhe argumentet kryesore nuk u vlerësuan, por gjykatat u mjaftuan me narrativën e akuzës, duke lënë pa dëgjuar dhe pa vlerësuar mbrojtjen.

7.1.3 Së drejtës për gjykim të drejtë dhe parimit të ligjshmërisë, pasi vendimet e gjykatave të faktit janë ndërtuar mbi boshllëqe serioze ligjore, që demonstrojnë se nga ajo që administrohet në dosjen gjyqësore gjykatat nuk mund të arrijnë në konkluzionin e shpallur prej tyre. Asnjë nga nenet e cituara nga gjykatat nuk e ndalon oficerin e policisë të marrë informacione nga burime konfidenciale, të ndërveprojë me homologë të huaj ose të organizojë postblloqe për kapjen e drogës. Asnjë oficer policie nuk ka qenë ndonjëherë i ndjekur penalisht për shkelje të rregullores, por shkelja e saj është trajtuar me masa disiplinore. Gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë faktin se mungonte qëllimi kriminal në veprimet e kërkuesit, porse ai ka vepruar për të mbështetur një interes publik dhe në kuadër të luftës kundër trafikimit të lëndëve narkotike. Ndërkohë që nga provat e administruara eprorët e tij kanë qenë në dijeni dhe kanë pranuar komunikimet e kërkuesit. Gjykatat e kanë anashkaluar faktin se veprimi ka sjellë arrestimin e një trafikanti ndërkombëtar, sekuestrimin e drogës dhe forcimin e frymës së bashkëpunimit dhe besimit me palën italiane. Po kështu, ato shndërruan një ide në provë për shpërdorim detyrë, pa sjellë asnjë element që ta mbështeste vendosjen e pajisjeve gjurmuese, e cila nuk u vendos kurrë, duke konkluduar se ishte rrezikuar jeta e dikujt.

7.1.4 Standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje çështjeve me natyrë abstrakte që ishin konkretizuar në mënyrë të shtrembër dhe të padrejtë nga gjykatat e faktit. Megjithatë ai ka paraqitur një rekurs të detajuar, Gjykata e Lartë është mjaftuar me formula standarde në arsyetimin e vendimit të saj, ajo nuk ka kryer asnjë analizë se përse precedentët e mëparshëm ishin të pazbatuar në rastin konkret. Mungesa e një përgjigjeje substanciale e kthen vendimin në një klishe procedurale, pa transparencë dhe, si pasojë, pa besueshmëri. Gjykata e Lartë nuk ka dhënë argumente për zgjerimin e paligjshëm të normave në fushën penale. Në këtë mënyrë ajo i ka mohuar kërkuesit mjetin efektiv që garantohej nga neni 13 i KEDNJ-së. Zgjerimi i paligjshëm i fushës penale mbetet i pakontrolluar, kualifikimi juridik i gabuar nuk korrigjohet dhe statusi i tij si sinjalizues publik i aferave kriminale të rangjeve të larta të pushtetit nuk merret në konsideratë. Ndërsa vendimet e gjykatave të faktit, ndonëse me arsyetim të zgjeruar, nuk kanë siguruar aspak harmonizim logjik të fakteve të provuara, me kuptimin e dispozitave ligjore të analizuara dhe vendimmarrjes në fund. Arsyetimi i gjykatave ka dalë tërësisht i paharmonizuar me provat dhe me vetë tekstin e ligjit, pasi ka mangësi në identifikimin e ligjit të shkelur, pasojat janë hipotetike, në vend të ligjit konsiderohen rregullore, ka cilësim të gabuar të faktit penal dhe shpërfillje të provave shfajësuese. Ndërkohë që mangësitë e dy gjykatave të faktit nuk janë korrigjuar nga Gjykata e Lartë, e cila me refuzimin stereotip ka shteruar mjetet e brendshme dhe ka reduktuar rekursin në një hap formal ankimi.

7.2 Parimin e proporcionalitetit për sa i takon masës së dënimit, pasi burgimi nuk është lloji i duhur i sanksionimit. Dënimi me 4 vjet e 6 muaj burgim tejkalon praktikën vendase për shpërdorim detyrë, ndërkohë që në raste shumë më të rënda, si me dëm ekonomik, përfitim personal e afëra korruptive, gjykatat kanë dhënë masa më të ulëta dënimi nga 1- 3 vjet burgim dhe shpesh me pezullim dënimi. Në rastin e kërkuesit pa dëm ekonomik, pa pasojë konkrete, në kryerje të detyrave parësore për të luftuar trafikun e drogës është vendosur maksimumi praktik i dënimit. Në rastin e dënimit të tij nuk janë trajtuar shumë nga rrethanat për lehtësimin e dënimit, sikurse parashikon

neni 49 i KP-së dhe po kështu është shkelur parimi i individualizimit të dënimit. Dënimi është i ashpër dhe e kthen sistemin penal në instrument ndëshkimi joproporcional.

7.3 *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi ndaj tij është krijuar një atmosferë paragjyquese tipike dhe po kështu gjykatat kanë përdorur një gjuhë që sugjeron fajësi të paracaktuar pa pasur prova dhe pa dhënë arsyetim ligjor për elementet e veprës penale, shtuar edhe refuzimin e Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar realisht rekursin. Presioni publik dhe institucional ka spostuar barrën e provës te kërkuesi. Lidhja shkakësore ka mbetur e paprovuar, kërkuesi nuk kishte as rol organizativ dhe as drejtues në aksionin e policisë objekt të çështjes, pasi këtë rol e kishin eprorët e tij, por asnjë nga këto hallka nuk janë dokumentuar. Ndërkohë që hetimi për trafik ndërkombëtar rezultoi që ishte në fazë të hershme dhe rezultati i tij mbeti tërësisht i pasigurt. Pra, pasoja është një skenar *a contrario* dhe jo një fakt i ndodhur, ndaj gjykatat kanë shkelur standardin që kërkon vërtetimin e fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në rastin e kërkuesit, është kriminalizuar gabimi administrativ i paaprovuar dhe i supozuar. Duke e mbështetur fajësinë mbi një dëm hipotetik, vendimet kanë ndryshuar rregullin se dyshimet shkojnë në favor të të pandehurit, duke cenuar standardin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

7.4 *Të drejtën për të mos u dënuar pa ligj*, të garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë zbatuar nenin 248 të KP-së pa një referencë të saktë ligjore për shkeljen e normave që veprojnë si ligje që rregullojnë punën e zyrtarit, nuk tregojnë pse pasojat hipotetike mjaftojnë për ngarkimin e fajësisë, pse një kundërvajtje konsiderohet krim për efekt të moskallëzimit të krimit. Në rastin e tij, rregulloret e tilla janë dhënë fuqia e ligjit në kundërshtim me praktikën e vet Gjykatës së Lartë dhe u shkel detyrimi për parashikueshmërinë e sjelljes së kriminalizuar. Neni 248 i KP-së kërkon shkelje të ligjit dhe jo të rregullores, po kështu, një oficer policie nuk mund të parashikojë që shkelja e një akti nënligjor (vendim ose udhëzim) do t'i sjellë burgim. Ndonëse gjykatat kanë cituar ligjin për Policinë e Shtetit dhe disa nene për Policinë Gjyqësore, ato nuk kanë bërë lidhjen mes normës dhe sjelljes, ndaj listimi i normave nuk ka vlerë juridike, për rrjedhojë parimi *nullum crimen sine lege* mbetet i paplotësuar. Gjykatat e kanë konsideruar deklarin e rremë të një nëne për të ndihmuar djalin e saj pas një aksidenti automobilistik që u paraqit si autore e veprës, si të ishte “krim”, në kuptim të nenit 300 të KP-së, ndërkohë që ky kod këtë veprim e klasifikon si kundërvajtje penale në nenet 305/a dhe 305/b. Për më tepër që neni 32 i Kushtetutës dhe paragrafi i dytë, i nenit 300 të KP-së i përjashtojnë prindërit dhe fëmijët e autorit nga detyrimi për kallëzim.

7.5 *Statusin e sinjalizuesit*, pasi në rrethanat ku vepronte kërkuesi, zgjedhja për t'iu drejtuar mediave dhe jo zinxhirit komandues ishte e vetmja rrugë racionale. Ngjarja ka ndodhur përpara miratimit të ligjit për sinjalizuesit, i cili ka hyrë në fuqi në datën 1.10.2016. Në kohën e ngjarjes, ministri i Brendshëm i kohës gëzonte pushtet të jashtëzakonshëm, i mbiquajtur “Superministri” i qeverisë. Lidhjet e tij me një grup kriminal ishin pikërisht objekti i sinjalizimit. Raportimi përmes zinxhirit komandues mund të nënkuptonte raportim direkt te personi i përfshirë, pra asgjësim i menjëhershëm i provave dhe rrezik për jetën e sinjalizuesit. Ka pasur disa dështime të operacioneve për kapjen e trafikantëve të drogës, ndaj dyshohej se kishte rrjedhje informacioni. Gjykata e Lartë duhet t'i akordonte kërkuesit mbrojtjen që i njeh konventa sinjalizuesve dhe jo dënim penal.

7.6 *Garancitë e nenit 18 të KEDNJ-së*, pasi të gjitha rrethanat e dosjes tregojnë se prokuroria dhe gjykatat kanë përdorur akuzat ndaj kërkuesit për një objektiv krejtësisht tjetër nga ndëshkimi i shpërdorimit të detyrës, atë të diskreditimit dhe izolimit profesionalisht dhe të pengimit që ai të vazhdonte denoncimet mbi korrupsionin e niveleve të larta. Kufizimet e vendosura ndaj tij, si arrestimi, ndjekja penale, dënimi, stigmatizimi publik, nuk shërbyen për parandalimin e krimit ose

për ruajtjen e rendit publik. Rezultatet e punës së tij në dëm të personave me pushtet e kanë sjellë në pikën që ai të strehohej në një azil politik dhe të kërkojë nga Gjykata të dëgjohet për herë të parë nga drejtësia, për të mos normalizuar dënime që japin mesazhe se policët e ndershëm nuk kanë asnjë rrugë të sigurt. Kur sistemi është i korruptuar, improvizimi është arsyeshëm jo i kundërligjshëm dhe i mbrojtur, duke u shërbyer nevojave për një shoqëri demokratike.

8. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

8.1 *Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi kjo e drejtë është respektuar në përputhje me standardet kushtetuese dhe me ato të KEDNJ-së. Argumentet e kërkuarit nuk gjejnë mbështetje faktike, në kushtet kur:

8.1.1 Kërkuari nuk paraqiti asnjë kërkesë gjatë gjykimit për përjashtimin e gjyqtarëve ose ndonjë ankesë procedurale gjatë gjykimit për paragjykimin politik. Nëse do të kishte prova ose shenja të ndikimit, ishte e pritshme që mbrojtja t'i adresonte, ndërkohë që nuk figuron asnjë gjë e tillë. Gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e konfirmuar atë pa ndryshuar ose shtuar akuza të reja. Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatave nuk vihet në dyshim objektivisht. Fakti që kërkuari u dënua, nuk do të thotë se gjyqi ishte i anshëm, do të duhej të provehej se gjykata vendosi me paragjykim. Gjykatat i kanë dhënë vlerë çdo prove pa pasur asnjë lloj paragjykimi, pa gjetur në asnjë moment tone emocionale ose politike. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme nuk qëndron.

8.1.2 Provat u administruan në gjykatën e shkallës së parë në prani të mbrojtjes, e cila pati mundësi t'i kundërshtonte ato në çdo aspekt, por nuk arriti të rrëzonte fuqinë provuese të tyre, ndërsa gjykata e apelit nuk e ka vlerësuar të nevojshme kërkimin dhe marrjen e provave të reja. Gjykatat e zakonshme kanë analizuar dosjen në themel, kanë vlerësuar të plota hetimet gjyqësore të kryera nga organi i akuzës, rezultatet e të cilave iu nënshtruan plotësisht debatit gjyqësor, ndaj pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve është i pabazuar.

8.1.3 Gjykimi ka qenë i drejtë dhe i ligjshëm, pasi gjykatat kanë adresuar çështjet kyçe me të cilat është sqaruar çdo detaj që u përket rrethanave të rastit. Kërkuari nuk ka informuar strukturat paralele dhe eprore që do të thotë se ai ka vepruar pa miratimin e nevojshëm institucional. Gjykata e apelit ka deduktuar logjikisht se veprimet klandestine të kërkuarit kanë ekspozuar informatorët e tij ndaj një rreziku edhe nëse ai rrezik nuk u materializua, sërish potenciali për rrezik është aty dhe kjo u konsiderua në vlerësimin e fajësisë. Sipas gjykatave të faktit, dëshmitë dhe transkriptet e komunikimit kanë treguar qartë se kërkuari u angazhua në aktivitete të rrezikshme, gjë që justifikon konsiderimin e pasojave të mundshme negative. Gjykata e Lartë ka konstatuar se vendimi i gjykatës së apelit është i argumentuar mjaftueshëm në çdo drejtim thelbësor, si për cilësimin juridik, ashtu edhe për provueshmërinë e fajësisë.

8.1.4 Gjykatat i kanë dhënë përgjigje çdo pretendimi të palëve, përfshirë edhe ato të mbrojtjes së kërkuarit, duke i arsyetuar në raport me ligjin e zbatueshëm, si atë material, ashtu edhe atë procedural penal. Procesi gjyqësor ishte i detajuar, i gjatë dhe me dy nivele shqyrtimi real. Po kështu, rekursi i tij është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë. Kërkuari ka realizuar mbrojtje ligjore gjatë gjithë kohës, ka pasur mundësi të paraqiste provat dhe argumentet e tij, të cilat u konsideruan nga gjykatat, ndonëse nuk u pranuan. Vendimet gjyqësore janë të arsyetuara dhe të mbështetura në prova objektive pas ekzaminimeve dhe debatit në seancat gjyqësore të çdo prove të administruar në gjykim. Pretendimet e tij janë thjesht perceptime të pambështetura. Rrjedhimisht, gjykatat e kanë përmbushur *standardin e arsyetimit të vendimit* dhe kanë garantuar *të drejtën e aksesit* të kërkuarit.

8.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të proporcionalitetit për sa i takon masës së dënimit* nuk qëndron, pasi, pavarësisht këndvështrimit personal për një masë dënimi më të butë, ligjërisht nuk gjendet asnjë element paligjshmërie në masën e caktuar nga gjykatat ndaj kërkuesit. Gjykatat, me të drejtë, kanë arritur në përfundimin se me veprimet dhe mosveprimet e kërkuesit kanë ardhur pasoja reale. Ligji penal nuk kërkon që shpërdorimi i detyrës të ndëshkohet lehtë, përkundrazi, ai shihet si një vepër serioze që dëmton autoritetin e shtetit dhe të shtetasve. Masa e dënimit nuk është disproporcionale, pasi dënimi me 4.5 vjet burgim ndaj një ish-oficeri policie vlerësohet brenda të gjitha standardeve të dënimeve për veprat penale në fjalë.

8.3 Pretendimi për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* është i pabazuar, pasi nuk ka asnjë provë konkrete që trupat gjykuese të jenë ndikuar nga deklaratimet e zyrtarëve të lartë (Kryeministri dhe ministri i Brendshëm i kohës). Vendimet gjyqësore janë bazuar në prova dhe në argumente ligjore specifike të analizuara dhe të ekzaminuara, të cilat nuk lënë shteg që të duket se janë ndikuar nga komentet ose ndikimet e politikës. Nuk gjendet në to asnjë shenjë se gjykata ka huazuar gjuhë ose supozime nga deklaratat publike, përkundrazi, duket qartë se vendimmarrja buron nga analiza e provave (përgjimet, dëshmitë etj.), pas kryerjes së një procesi të plotë, debati gjyqësor, duke mos gjetur asnjë lidhje me përplasjet ose komentet e ndryshme mediatike. Nuk ka asnjë të dhënë që gjykatat ta kenë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar. Gjithashtu, nuk rezulton që gjatë procesit barra e provës të ketë kaluar nga prokurori tek kërkuesi.

8.4 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për të mos u dënuar pa ligj*, nuk qëndron, pasi veprat penale për të cilat është dënuar kërkuesi ekzistojnë në KP-në e kohës kur ai ka kryer veprimet/mosveprimet. Për sa i takon akuzës për shpërdorimin e detyrës, gjykatat kanë identifikuar dispozitat ligjore konkrete të përfshira në ligjet për Policinë Gjyqësore, për Policinë e Shtetit, në KPP etj. Pra, nuk është e saktë që gjykatat janë mbështetur vetëm në akte nënligjore dhe në udhëzime të brendshme, pa norma konkrete. Thelbi i sjelljes së kërkuesit është se ai ka cenuar rendin juridik të brendshëm. Një zyrtar policie mesatar duhet dhe kishte detyrimin ligjor ta dinte se informacionet operationale për krime nuk duhet t'ia dërgojë një personi privat ose të huaj pa leje; vendosja e pajisjeve gjurmuese kërkon autorizim nga prokuroria, të kesh dijeni për një krim dhe ta fshehësh është vepër penale. Gjykatat nuk kanë bërë interpretim të zgjeruar të nenit 248 të KP-së, por thjesht e kanë zbatuar këtë dispozitë në një skenar specifik. Për më tepër, Gjykata e Lartë ka theksuar se praktika e saj për nenin 248 të KP-së është respektuar. Lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 300 i KP-së, ligji i ngarkon punonjësit e shtetit (përfshirë policinë) me përgjegjësi që të kallëzojnë çdo vepër penale që mësojnë gjatë ushtrimit të detyrës. Vepra penale që kërkuesi me dashje ka shtyrë/anashkaluar kallëzimin përbën krim jo kundërvajtje nëse ka rrezik të caktuar. Pretendimet e tij nuk gjejnë mbështetje ligjore, pasi neni 300 i KP-së nuk bën dallime sipas lidhjes familjare ose madhësisë së krimit.

8.5 Pretendimi për mungesën e mbrojtjes për *statusin e sinjalizuesit* është i pabazuar, pasi kërkuesi ka zgjedhur një rrugë jashtë rregullave si sinjalizim. Në vend që të paraqitej si dëshmitar ose të informonte organet e brendshme antikorruption, ai vendosi të bënte një aksion paralel e pastaj të dilte në media. Kjo lloj qasjeje, sado e motivuar nga qëllimi për të nxjerrë të vërtetën, nuk e shfajëson atë nga ndjekja penale për hapat e jashtëligjshëm që ka ndërmarrë. Gjykata duhet të peshojë interesin publik si rrethanë lehtësuese, por nuk mund ta shpallë të pafajshëm dikë që objektivisht ka kryer elementet e një vepre penale. Gjykata e apelit ka argumentuar se veprimet e kërkuesit ishin të karakterit privat dhe jo institucional, pa asnjë platformë të miratuar dhe se ai ka vepruar individualisht.

8.6 Pretendimi për cenimin e *garancive të nenit 18 të KEDNJ-së* është i pabazuar në prova dhe në ligj, pasi nuk ka asnjë provë bindëse që procedimi penal ndaj kërkuesit kishte si qëllim real diçka tjetër, jashtë zbatimit normal të ligjit penal. Rasti i kërkuesit për shkak të situatës mediatike duket sikur ka edhe kontekst politik, për faktin se ai ka implikuar zyrtarë të lartë duke u bërë edhe subjekt debatesh. Situata të tilla nuk mjaftojnë për të thënë se i gjithë sistemi ka komplotuar për ta dënuar kërkuesin pa të drejtë, pasi edhe i gjithë procesi i të provuarit tregon tjetër situatë. Dënimi i kërkuesit mund të duket i ashpër, por është brenda kuadrit ligjor. Rrethanat provojnë katërcipërisht shkelje të ligjit nga një oficer policie, i cili, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka kryer vepra penale për të cilat me të drejtë është deklaruar fajtor dhe është dënuar duke u vlerësuar në të tria shkallët e gjykimit. Vendimi përfundimtar i Gjykatës së Lartë rreshton një sërë argumentesh juridike se përse rekursi i tij nuk duhet pranuar. Sistemi ka vepruar brenda misionit të tij legjitim, pavarësisht se rezultati nuk i ka ardhur për shtat kërkuesit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a, të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kriterëve të legjitimitimit dhe jurisprudencën e saj, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae* dhe *ratione temporis* janë të përmbushura. Në lidhje me to, nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme, ndërsa as subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, nuk ka paraqitur ndonjë prapësim.

11. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka theksuar se kërkuesi duhet t'i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial (*shih vendimet nr. 48, datë 8.4.2026; nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 38, datë 12.7.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Lidhur me aspektin formal, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj duke kundërshtuar vendimet gjyqësore që kanë vendosur për akuzat ndaj tij, rrjedhimisht i ka përdorur formalisht të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për sa i takon aspektit substancial, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se gjykatat e zakonshme kanë cenuar *parimin e proporcionalitetit të lidhur me masën e dënimit*, pasi dënimi me 4 vjet e 6 muaj burgim tejkalon praktikën vendase për shpërdorim detyrë (*shih paragrafin 7.2 të vendimit*). Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se ai nuk qëndron, pasi nuk gjendet asnjë element paligjshmërie në masën e dënimit (*shih paragrafin 8.2 të vendimit*).

13. Gjykata vëren se ky pretendim nuk është ngritur në mjetet e ankimit të ushtruara në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (apel, rekurs dhe shtesë rekursi), duke u parashtruar për herë të parë

në ankimin kushtetues individual drejtuar Gjykatës, ndaj, në këto rrethana, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion lidhur me të.

14. Ndërsa për pretendimet e tjera, për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor në disa drejtime (gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, barazia e armëve, gjykimi i drejtë dhe parimi i ligjshmërisë, si dhe standardi i arsyetimit i vendimit i lidhur me aksesin)*, parimit të prezumimit të pafajësisë, *së drejtës për të mos u dënuar pa ligj, statusit të sinjalizuesit dhe garancive të nenit 18 të KEDNJ-së*, Gjykata vëren se ndonëse një pjesë të tyre kërkuesi nuk i ka artikulluar nën emërtimin e këtyre parimeve dhe garancive, ai i ka parashtruar ato në substancë përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë nuk ka më mjete të tjera ligjore në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

15. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, pretendimin për cenimin e *statusit të sinjalizuesit*, duke argumentuar se në rrethanat ku operonte, zgjedhja për t'iu drejtuar mediave dhe jo zinxhirit komandues ishte e vetmja rrugë racionale (*shih paragrafin 7.5 të vendimit*). Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se në vend që të paraqitej si dëshmitar ose të informonte organet e brendshme antikorrupsion, kërkuesi vendosi të bënte një aksion paralel e pastaj të dilte në media (*shih paragrafin 8.5 të vendimit*).

16. Gjykata vëren se, në thelb, pretendimi i kërkuesit lidhet me veprimet e tij në kuadër të ushtrimit të një të drejte të parashikuar nga ligji nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” (*ligji nr. 60/2016*), ndaj argumentet e tij do të verifikohen në këtë drejtim, pra në kuptim të garancive të ofruara nga ky ligj. Në këtë këndvështrim, konstatohet se kërkuesi: i. në periudhën 2013–2014 është proceduar penalisht; ii. në janar të vitit 2014 është urdhëruar regjistrimi i emrit të tij si person nën hetim për veprën penale të shpërdorimit të detyrës; iii. në nëntor të vitit 2014 ka marrë cilësinë e të pandehurit për veprën penale të shpërdorimit të detyrës dhe moskallëzimit të krimit; iv. në dhjetor të vitit 2014 prokuroria e ka njoftuar atë për përfundimin e hetimeve; v. në shkurt të vitit 2015 gjykata e krimeve të rënda ka vendosur dërgimin e çështjes në gjykatën e Fierit; vi. në shtator të vitit 2015 ai është larguar nga vendi i qëndrimit (banesa).

17. Në datën 2.6.2016, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 60/2016, i cili ka përcaktuar për herë të parë, ndër të tjera, mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e autoriteteve publike e të subjekteve private për sinjalizimin. Ligji i shtrinte efektet e tij prej datës 1.10.2016. Në analizë të këtyre rrethanave, Gjykata vëren se ngjarjet mbi të cilat janë ngritur akuzat ndaj kërkuesit dhe fillimi i procedimit penal kanë ndodhur përpara miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit për sinjalizuesit. Kjo do të thotë se, në rastin e kërkuesit, nuk gjen zbatim ligji për statusin e sinjalizuesit, për rrjedhojë pretendimi tij nuk qëndron.

18. Kërkuesi ka pretenduar *cenimin e garancive të nenit 18 të KEDNJ-së*, pasi, sipas tij, të gjitha rrethanat e dosjes tregojnë se prokuroria dhe gjykatat kanë përdorur akuzat për një objektiv krejtësisht tjetër nga ndëshkimi për shpërdorimin e detyrës, atë të diskreditimit dhe të izolimit profesionalisht dhe të pengimit, që ai të vazhdonte denoncimet për veprimet e paligjshme të funksionarëve në nivelet e larta (*shih paragrafin 7.6 të vendimit*). Ky pretendim është prapësuar si i pabazuar nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, i cili ka argumentuar se nuk ka asnjë provë bindëse që procedimi penal ndaj kërkuesit kishte si qëllim real diçka tjetër, jashtë zbatimit normal të ligjit penal (*shih paragrafin 8.6 të vendimit*).

19. Neni 18 i KEDNJ-së parashikon kufijtë e zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave dhe lirive për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë parashikuar. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka pranuar se sipas këtij neni, shqyrtimi i veçantë i një ankese është i justifikuar vetëm nëse pretendimi se një kufizim është aplikuar për një qëllim që nuk përcaktohet nga Konventa duket të jetë aspekt themelor i çështjes (*shih Merabishvili kundër Gjeorgjisë [DhM]*,

28.11.2017, § 291; *Navalnyy kundër Rusisë [DhM]*, 15.11.2018, § 164; *Kavala kundër Turqisë*, 10.12.2019, § 198). Megjithatë, një aplikant që pretendon se të drejtat dhe liritë e tij janë kufizuar për një arsye të papërshtatshme duhet të tregojë bindshëm se qëllimi i vërtetë i autoriteteve nuk ishte i njëjtë me atë të shpallur (ose siç mund të nxirret në mënyrë të arsyeshme nga konteksti). Një dyshim i thjeshtë se autoritetet përdorën kompetencat e tyre për ndonjë qëllim tjetër nga ato të përcaktuara në Konventë nuk është i mjaftueshëm për të provuar se neni 18 është shkelur (*shih Khodorkovskiy kundër Rusisë*, 31.5.2011, §§ 255 dhe 258). Gjithashtu, GJEDNJ-ja është shprehur se kur bëhet fjalë për pretendime për motive politike ose motive të tjera, të fshehta në kontekstin e ndjekjes penale, është e vështirë të dallohet ndjekja e qëllimshme nga procedurat penale të ndalimit (*shih Lutsenko kundër Ukrainës*, 3.7.2012 §§ 106–110).

20. Gjykata, duke pasur në konsideratë se thelbi i këtij pretendimi lidhet me bazueshmërinë në ligj dhe në prova të ndëshkimit penal të kërkuarit, çmon të analizojë argumentet e tij në këndvështrim të *parimit të prezumimit të pafajësisë*.

21. Po kështu, kërkuari ka pretenduar cenimin e *së drejtës për gjykim nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, bazuar në argumentet se ndaj tij nuk është zhvilluar një hetim i plotë dhe i gjithanshëm, ndërsa gjykatat e faktit e kanë pranuar akuzën sikurse është paraqitur dhe Gjykata e Lartë nuk e ka trajtuar pretendimin për hetim selektiv dhe represion institucional. Ai ka sjellë një sërë provash që nëse do të vlerësoheshin në mënyrë të paanshme do të rrëzonin premisën e fajësisë (*shih paragrafin 7.1.1 të vendimit*). Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se pavarësia dhe paanshmëria e gjykatave nuk vihen në dyshim objektivisht, fakti që kërkuari u dënua nuk do të thotë se gjyqi ishte i anshëm. Kërkuari nuk paraqiti asnjë kërkesë gjatë gjykimit për përjashtimin e gjyqtarëve apo ndonjë ankesë procedurale gjatë gjykimit lidhur me paragykimin e çështjes së tij (*shih paragrafin 8.1.1 të vendimit*).

22. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet. Paanshmëria duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, *testin subjektiv*, në kuptim të të cilit paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta dhe *testin objektiv*, se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjyqësor, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në zbatim të këtij standardi, Gjykata vëren se kërkuari nuk ka kërkuar gjatë gjykimit përjashtimin e ndonjë gjyqtari për shkaqe që lidhen me sjelljen gjatë gjykimit dhe që do të mund të vinin në dyshim paanshmërinë, ndaj, në *aspektin subjektiv*, argumentet e tij nuk janë të mjaftueshme të përmbysin prezumimin e paanshmërisë së gjykatës. Ndërsa në *aspektin objektiv*, duke qenë se argumentet e kërkuarit, në thelb, lidhen me ligjshmërinë e provueshmërisë së fajësisë së tij përtej dyshimit të arsyeshëm, ato do të analizohen të ndërlidhura me parimin e *prezumimit të pafajësisë*.

24. Gjithashtu, kërkuari ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë së armëve*, me argumentin se akuza u lejua të mbështetej në hipoteza, ndërsa mbrojtjes iu mohua forma shfajësuese e provave të saj. Kjo gjë solli mungesën e kontrollit substancial, sepse provat dhe argumentet kryesore nuk u vlerësuan, por gjykatat u mjaftuan me narrativën e akuzës, duke lënë pa dëgjuar dhe pa vlerësuar mbrojtjen (*shih paragrafin 7.1.2 të vendimit*). Po kështu, sipas kërkuarit, atij i është cenuar *e drejta për gjykim të drejtë dhe parimi i ligjshmërisë*, sepse vendimet e gjykatave të faktit janë ndërtuar mbi boshllëqe serioze ligjore, ndërsa e anashkaluan faktin se veprimet sollën arrestimin e një trafikanti ndërkombëtar, sekuestrimin e drogës dhe forcimin e frymës së bashkëpunimit dhe besimit me palën italiane, si dhe e shndërruan një ide në provë për shpërdorim detyrë, pa sjellë

asnjë element që ta mbështesë vendosjen e pajisjeve gjurmuese, e cila nuk u vendos kurrë (*shih paragrafin 7.1.3 të vendimit*). Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, sepse gjykatat kanë përdorur një gjuhë që sugjeron fajësi të paracaktuar, pa pasur prova dhe pa dhënë arsytim ligjor për elementet e veprës penale, shtuar edhe refuzimin e Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar realisht rekursin (*shih paragrafin 7.3 të vendimit*). Gjithashtu, ai ka pretenduar cenimin e *së drejtës për mos u dënua pa ligj*, pasi ndonëse gjykatat kanë cituar ligjin për Policinë e Shtetit dhe disa nene për Policinë Gjyqësore, ato nuk kanë bërë lidhjen mes normës dhe sjelljes, ndaj listimi i normave nuk ka vlerë juridike, për rrjedhojë parimi *nullum crimen sine lege* mbetet i paplotësuar. Po sipas kërkuesit, gjykatat e kanë konsideruar deklarinimin e rremë të një nëne për të ndihmuar djalën e saj si të ishte “krim”, në kuptim të nenit 300 të KP-së, ndërkohë që KP-ja këtë veprim e klasifikon si kundërvajtje penale në nenet 305/a dhe 305/b (*shih paragrafin 7.4 të vendimit*).

25. Për sa u përket këtyre pretendimeve, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë, nga njëra anë, natyrën kushtetuese të argumenteve mbështetëse, thelbi i të cilave lidhet me mënyrën sesi gjykatat e faktit kanë arsyetuar çështjen dhe kanë vendosur mbi fajësinë e kërkuesit, ndërsa Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi ka disponuar me arsytim të kufizuar mospranimin e rekursit dhe, nga ana tjetër, se kushdo në rastin e akuzave të ngritura kundër tij ka të drejtën e një gjykimi të drejtë (*neni 42, pika 2, i Kushtetutës*), çmon t’i trajtojë ato në aspektin e garancive kushtetuese për proces të rregullt ligjor, duke i verifikuar në drejtim të *së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, të cilat hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, ndaj ajo do të analizojë në vijim bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

26. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje çështjeve me natyrë abstrakte që ishin konkretizuar në mënyrë të shtrembër dhe të padrejtë nga gjykatat e faktit. Megjithatë ai ka paraqitur një rekurs të detajuar, Gjykata e Lartë u mjaftua me formula standarde në arsytimin e vendimit të saj, duke mos kryer asnjë analizë se përse precedentët e mëparshëm ishin të pazbatuar në rastin konkret. Mungesa e një përgjigjeje substanciale e kthen vendimin në një klishe procedurale, pa transparencë dhe, si pasojë, pa besueshmëri. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka dhënë argumente për zgjerimin e paligjshëm të normave në fushën penale. Në këtë mënyrë ajo i ka mohuar kërkuesit mjetin efektiv që garantohet nga neni 13 i KEDNJ-së. Zgjerimi i paligjshëm i fushës penale mbetet i pakontrolluar, kualifikimi i gabuar juridik nuk korrigjohet dhe statusi i tij si sinjalizues publik i aferave kriminale të rangjeve të larta të pushtetit nuk merret në konsideratë. Po sipas kërkuesit, ndërsa vendimet e gjykatave të faktit, ndonëse me arsytim të zgjeruar, nuk sigurojnë aspak harmonizim logjik të fakteve të provuara, me kuptimin e dispozitave ligjore të analizuara dhe vendimmartjes në fund. Sipas kërkuesit, arsytimi i gjykatave ka dalë tërësisht i paharmonizuar me provat dhe me vet tekstin e ligjit, pasi ka mangësi në identifikimin e ligjit të shkelur, pasojat janë hipotetike, në vend të ligjit konsiderohen rregullore, ka cilësim të gabuar të faktit penal dhe shpërfillje të provave shfajësuese. Gjithashtu, ka pretenduar kërkuesi, gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë zhvillimet e kohës lidhur me procesin penal ndaj ministrit të Brendshëm për shkak të lidhjeve me grupe kriminale, fakte këto të denoncuar prej tij dhe as faktin e përfitimit të azilit politik për shkak të procedurave gjyqësore dhe pasigurisë së tij. Gjithashtu, sipas kërkuesit, ato nuk i kanë dhënë përgjigje se cilat ishin veprimet me informatorin që përbënin krim dhe jo kundërvajtje penale në rastin e moskallëzimit. Ndërkohë që mangësitë e

të dyja gjykatave të faktit nuk u korrighuan nga Gjykata e Lartë, e cila me refuzimin stereotip e ka reduktuar rekursin në një hap formal ankimi.

27. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se gjykatat i kanë dhënë përgjigje çdo pretendimi të palëve, përfshirë edhe ato të mbrojtjes së kërkuesit, duke i arsyetuar në raport me ligjin e zbatueshëm, si atë material, ashtu edhe atë procedural penal. Procesi gjyqësor ishte i detajuar, i gjatë dhe me dy nivele shqyrtimi real dhe rekursi i kërkuesit është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë. Sipas tij, kërkuesi ka realizuar mbrojtje ligjore gjatë gjithë kohës dhe ka pasur mundësi të paraqiste provat dhe argumentet e tij, të cilat janë konsideruar nga gjykatat, ndonëse nuk janë pranuar. Sipas subjektit të interesuar, vendimet gjyqësore janë të arsyetuara dhe të mbështetura në prova objektive, të cilat janë nënshtruar debatit gjatë gjykimit. Po sipas subjektit të interesuar, pretendimet e tij janë thjesht perceptime dhe të pambështetura.

28. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Po kështu, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, funksioni i të cilit është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.5.2023; nr. 11, datë 10.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, ka theksuar Gjykata, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme **dhe, në mënyrë të veçantë**, i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 67, datë 5.11.2025; nr. 20, datë 11.4.2025; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*), e cila, **në kuadër** të parimit të *subsidiaritetit*, që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e pretendimeve të natyrës kushtetuese të ngritura në rekurs dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 27, datë 29.5.2025; nr. 5, datë 29.1.2025; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*). Mungesa e arsyetimit në vendim për shkaqet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs dhe në shtesën e rekursit vë në dyshim të drejtën e kërkuesit për t'u dëgjuar për të gjitha pretendimet e tij (*shih vendimet nr. 77, datë 5.11.2024; nr. 19, datë 7.7.2022, të Gjykatës Kushtetuese*), duke sjellë, si pasojë, edhe cenimin e së drejtës së aksesit (*shih vendimin nr. 50, datë 25.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në të njëjtën linjë, edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së ka pranuar se garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së zbatohen, në parim, edhe për rekursin në kasacion, kur këto përbëjnë një fazë të mëtejshme të procedurës penale dhe kur rezultatet e tyre mund të jenë vendimtare për personin e dënuar (*shih Meftah dhe të tjerë kundër Francës [DhM], 26.7.2002, § 40*). Po ashtu, GJEDNJ-ja ka theksuar se ndonëse e drejta e apelimit mund t'u nënshtrohet kushteve ligjore, gjykatat duhet, në zbatimin e rregullave procedurale, të shmangin një formalizëm të tepruar që do të cenonte rregullsinë e procedurës dhe vetë thelbin e së drejtës për akses në një gjykatë, sidomos duke pasur parasysh rëndësinë e ankimit dhe mundësinë që ai i jep një të dënuari me një masë të rëndë heqjeje lirie për t'u nënshtruar shqyrtimit nga gjykata më e lartë (*shih Walchli kundër Francës, 26.7.2007, § 29; Labergère kundër Francës, 26.9.2006, §§ 20, 23*).

31. Në dritën e standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimet e të tria shkallëve të gjykimit. Gjykatat e faktit e kanë deklaruar atë fajtor për dy vepra penale, për të cilat ai është akuzuar nga organi i prokurorisë, duke arsyetuar se fajësia e tij provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin

se ai nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga ligji. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës, duke pretenduar se procesi penal ndaj tij ka qenë i qëllimshëm, për shkak të fakteve të denoncuar për lidhjet e një funksionari të lartë publik (ministrit të Brendshëm) me elemente të krimit, arsye për të cilën është dënuar penalisht. Po sipas tij, për shkak të rrezikut që i kanoset, ai ka fituar statusin e azilit politik jashtë vendit (Konfederata Zvicerane) dhe për arsye sigurie i është lëshuar një identitet i ri administrativ.

32. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë rrethanat e mësipërme dhe në respekt të kufijve ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe atij të gjykatave të zakonshme, do të verifikojë nëse përgjigjja që kërkuesi ka marrë nga Gjykata e Lartë ndaj pretendimeve të tij përmbush standardet kushtetuese të aksesit substancial në gjykatë dhe të arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

33. Gjykata konstaton se kërkuesi ka ushtruar detyrën e shefit të seksionit për narkotikët në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier. Për shkak se gjatë ushtrimit të detyrës ka kryer veprime të paautorizuara nga eprorët dhe të palejuara nga ligji, ndaj tij është proceduar me masë administrative, duke e larguar nga detyra. Njëkohësisht, ndaj tij ka filluar edhe procedimi penal fillimisht për veprën penale të shpërdorimit të detyrës dhe më pas është shtuar edhe vepra penale e moskallëzimit të krimit, të mbështetura në faktet që lidhen me 4 episode kryesore.

34. Konkretisht, sipas prokurorisë, *episodi i parë* lidhet me ndërhyrjen e kërkuesit në një operacion për goditjen e një rasti të trafikimit ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Si pasojë e kësaj ndërhyrjeje, pretendohet se operacioni është ndërprerë, duke mos u bërë i mundur identifikimi i organizatorëve dhe pritësve të lëndës narkotike, ndërsa personat e arrestuar janë akuzuar dhe janë dënuar për një vepër penale më të lehtë. Gjithashtu, prokuroria pretendon se kërkuesi ka përfshirë në operacion një informator pa respektuar procedurat ligjore, duke e ekspozuar atë ndaj rrezikut dhe duke e privuar nga garancitë mbrojtëse të parashikuara nga ligji. *Episodi i dytë* lidhet me dhënien, pa autorizim dhe koordinim, e informacioneve një oficeri të Policisë Italiane për trafikimin e lëndëve narkotike nga shtetas shqiptarë. Sipas prokurorisë, ky veprim ka penguar autoritetet të vijonin hetimet për identifikimin e anëtarëve të tjerë të grupit kriminal dhe të pritësve të lëndës narkotike. *Episodi i tretë* lidhet me përpjekjet e kërkuesit për të kryer përgjime të paautorizuara. Sipas prokurorisë, ai ka rekrutuar në kundërshtim me ligjin bashkëshorten e informatorit për të kontrolluar dhe vendosur pajisje gjurmuese dhe përgjuese në banesën dhe automjetin e një personi të dyshuar për trafikim të lëndëve narkotike. *Episodi i katërt* lidhet me moskallëzimin e një aksidenti rrugor me pasojë vdekjen. Sipas prokurorisë, kërkuesi, ndonëse kishte dijeni për rrethanat e ngjarjes, nuk e ka kallëzuar atë, por është përpjekur të sigurojë mbrojtje ligjore për një person të përfshirë (bashkëshorten e informatorit, që po përpikte të shmangte nga përgjegjësia djalin e saj). Në përfundim të hetimeve, prokuroria ka vlerësuar se veprimet e kërkuesit kishin dëmton rëndë interesat e drejtësisë, kishin vënë në rrezik jetën dhe shëndetin e shtetasve, si dhe kishin cenuar sovranitetin e shtetit shqiptar, ndaj e ka dërguar çështjen në gjykatë, duke e akuzuar atë për veprat penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 300 të KP-së.

35. Çështja e kërkuesit është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, në datën 9.3.2015 dhe ka përfunduar në datën 19.11.2018, periudhë gjatë së cilës janë zhvilluar 28 seanca gjyqësore. Gjatë gjykimit janë administruar i. dëshmitë e personave që kanë pasur dijeni mbi ngjarjet (4 episode), për të cilat akuzohej kërkuesi, përfshirë kolegët dhe eprorët e tij; ii. korrespondenca shkresore për shkëmbimin e letërporosive me autoritetet e drejtësisë italiane fillimisht për të bërë të mundur pjesëmarrjen në gjykim dhe më pas për t'i marrë dëshminë me shkrim një punonjësi të policisë italiane me të cilin kërkuesi ka shkëmbyer informacione mbi ngjarje dhe situata që lidheshin me trafikimin e lëndëve narkotike nga Shqipëria në Itali; iii. rezultatet e kontrollit të kryer në banesën e kërkuesit, ekspertimet e telefonave celularë e të pajisjeve kompjuterike, si

DVD; iv. transkriptet e përgjimeve të komunikimeve telefonike dhe vëzhgimeve ambientale; v. informacionet e vëna në dispozicion nga institucione të ndryshme që kryejnë transferta parash; vi. të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS, si dhe prova të tjera.

36. Në përfundim, gjykata e shkallës së parë, me vendimin e datës 19.11.2018, ka vlerësuar provueshmërinë e fajësisë së kërkuesit sipas akuzave, pasi ekziston lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë midis veprimeve të kërkuesit dhe pasojës së ardhur, si element i domosdoshëm i anës objektive të veprës penale. Sipas saj, provohet se kërkuesi ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, kjo për faktin se me veprimet e tij ka cenuar marrëdhëniet juridike që kanë të bëjnë me përmbushjen e rregullt të detyrës, zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe urdhrave të dalë në bazë e për zbatim të ligjit, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të shtetasve. Sipas gjykatës, neni 248 i KPP-së është një dispozitë *blankete*, ndaj ajo i është referuar bazës ligjore që rregullon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore dhe Policisë së Shtetit, në fuqi në momentin e kryerjes së veprës penale, dispozitave të KPP-së, normave ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve, si dhe akteve ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe që veprojnë në fushën e ndihmës së ndërsjellë për çështje penale (*shih vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, faqet 77–92*). Ndërsa për sa i takon veprës penale të parashikuar nga neni 300 i KP-së, gjykata ka krijuar bindjen “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” se kërkuesi ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale të moskallëzimit të krimit lidhur me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor nga një shtetas dhe paraqitjen në komisarariat të nënës së tij, e cila ka marrë përsipër fajin në emër të djalit të saj. Sipas gjykatës, kërkuesi ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë jo vetëm duke mos i kallëzuar këta shtetas, por edhe duke i siguruar mbrojtje për veprimet e kundërligjshme, pasi ka parashikuar karakterin “shoqërisht të rrezikshme” të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme dhe të vullnetshme duke mos kallëzuar krimin e kryer nga të dy shtetasit (*shih vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, faqe 96*).

37. Ky arsyetim është vlerësuar i drejtë nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin e datës 4.6.2021, ka çmuar se veprimet e kërkuesit vijnë në kundërshtim me rregullat që normojnë kryerjen e detyrës dhe pasojën e tyre. Sipas gjykatës së apelit, kërkuesi, duke shfrytëzuar atributet si oficer i Policisë Gjyqësore, ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 294/a e vijues të KPP-së; informacionet e marra në rrugë konfidenciale nuk i administronte sipas ligjit organik të Policisë së Shtetit dhe ligjit procedural penal, por ia dërgonte një shtetasi të huaj të paaautorizuar dhe bashkëpunimi me të është kryer në kundërshtim me ligjin. Po kështu, sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë në pjesën arsyetuese ka cituar edhe nenet përkatëse të ligjeve të cilat janë shkelur nga kërkuesi. Gjykata e apelit ka vlerësuar se gjatë gjykimit në shkallë të parë është kryer një hetim i plotë i të gjitha provave të mbledhura nga organi i akuzës, dhe me të drejtë, pa i dhënë asnjë prove vlerë të paracaktuar, duke konkluduar se kërkuesi ka konsumuar elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, fakt, i cili u pasqyrua qartë dhe nga dëshmitë e dhëna nga personat e pyetur në këtë gjykim (*shih vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, faqe 76*). Në përfundim të shqyrtimit, gjykata e apelit ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë që ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprat penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 300 të KP-së dhe gjithçka është parashtruar nga mbrojtja në ankimin e tij dhe në parashtrimin në apel nuk hedhin dritë mbi asnjë fakt të ri që të konkludohet se kërkuesi është i pafajshëm dhe se veprimet e kryera prej tij nuk vijnë në kundërshtim me ligjin (*shih po aty, faqe 78*).

38. Kundër këtij vendimi në datën 19.7.2021, ka ushtruar rekurs kërkuesi dhe gjatë kohës që çështja ishte në pritje për shqyrtim nga Gjykata e Lartë, ai i është drejtuar sërish asaj në 23.12.2024, me parashtrime shtesë. Kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se: i. gjykatat nuk kanë përcaktuar konkretisht se cila dispozitë ligjore ose nënligjore është shkelur prej tij për shkak të detyrës së tij;

si shef seksioni dhe punonjës i policisë ai ka të drejtë dhe detyrë të marrë informacione për veprimtari kriminale, ndërsa për sa i përket vendosjes së pajisjeve gjurmuese në vende të ndryshme, ai ka komunikuar me eprorët e tij dhe nuk ka bërë operacione ose veprime të ngjashme, jashtë kompetencës së tij territoriale; ii. nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore ose nënligjore që të ndalojë mbledhjen e informacionit në lidhje me trafikun dhe trafikantët e drogës; edhe dëshmitarët e tjerë të pyetur në seancë gjyqësore konfirmojnë në përgjithësi pretendimet e tij; iii. gjykatat, në të dyja shkallët, kanë zbatuar keq ligjin, përmes një arsyetimi që nuk është në koherencë me ligjin dhe provat, duke cenuar parimin e mosdënimit pa ligj; iv. gjykata ka shpërfillur provat dhe parashikimet ligjore lidhur me hierarkinë dhe organizimin e veprimeve operacionale brenda strukturës së Policisë së Shtetit; v. nga rrethanat e faktit ka rezultuar se veprimet e kërkuesit ishin në përputhje me detyrat e tij të miratuara nga eprorët dhe ai nuk kishte kompetencën për të marrë vendime të pavarura në operacionet ku ishte i përfshirë; vi. edhe në kushtet kur mosveprimi i kërkuesit do të vlerësohej si mospërmbyllje e rregullt e detyrës, përsëri për të vërtetuar lidhjen shkakësore mungon pasoja, e cila në rastin konkret është hipotetike; vii. gjykatat, në të dyja nivelet, nuk kanë marrë në konsideratë natyrën e qëllimit të veprimeve të kërkuesit, i cili ka vepruar për të mbështetur një interes publik dhe në kuadër të luftës kundër trafikimit të lëndëve narkotike; viii. dhënia e informacionit pa autorizim dhe pa ndjekur procedurën e duhur ligjore, në mungesë të një qëllimi kriminal, mund të përbënte, në rastin më ekstrem, një shkelje disiplinore, por kurrësi një vepër penale; ix. gjykata nuk ka marrë parasysh kontekstin dhe qëllimin e përpjekjeve të kërkuesit për vendosjen e pajisjeve gjurmuese, në mënyrë që të vërtetohej katërcipërisht konsumimi i veprës penale të shpërdorimit të detyrës; x. është dënuar për veprën penale të moskallëzimit të krimit, në shkelje të hapur të parimit “*nulla crimen, nulla poena sine lege*”, pasi një nënë, e cila bën një deklaratë për të mbrojtur djalin e saj, duke marrë përsipër autorësinë e krimit, bën pjesë në kategorinë e personave që nuk ishin të detyruar të jepnin informacion/dëshmi për shkak të lidhjes së ngushtë familjare dhe deklarata e saj nuk mund të konsiderohet vepër penale sipas nenit 305/a të KP-së.

39. Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 18.2.2025, ka arsyetuar se ndryshe nga sa parashtrohet në rekurs, konstatohet sa shkaqet e rekursit marrin përgjigje nga vendimmarrja e gjykatës së apelit, e cila është argumentuar mjaftueshëm qoftë për sa i përket cilësimit/kualifikimit ligjor të faktit/ve penale të atribuuara kërkuesit, ashtu edhe në drejtim të provueshmërisë së fajësisë së tij për kryerjen e tyre. Gjithashtu, shprehet Gjykata e Lartë, në respektim të përcaktimeve procedurale penale (*nenit 383 të KPP-së*), gjykata e apelit, nga njëra anë, ka evidentuar dhe arsyetuar faktet dhe provat mbi të cilat ka bazuar vendimmarrjen dhe, nga ana tjetër, ka arsyetuar/argumentuar mjaftueshëm pabazueshmërinë e pretendimeve të paraqitura nga kërkuesi, të cilat në thelb janë parashtuar edhe si shkaqe rekursi, por pa i argumentuar ato, në referim në nenin 432 të KPP-së (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafët 15 dhe 16*). Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat më të ulëta kanë kryer një proces gjyqësor në konformitet me parimet bazë të procesit penal dhe në vendimmarrjet objekt rekursi nuk konstatohen shkelje që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit; pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose në kundërshtim me praktikën e asaj gjykate (*shih po aty, paragrafin 18*).

40. Gjykata konstaton se kërkuesi ka ngritur në rekurs dhe në parashtrimet shtesë një sërë pretendimesh me natyrë kushtetuese. Në thelb, ai ka pretenduar se gjykatat e faktit nuk kanë përcaktuar në mënyrë konkrete dispozitat ligjore ose nënligjore që ai ka shkelur për shkak të detyrës; nuk kanë analizuar rolin, kompetencat dhe përgjegjësitë e tij si shef seksioni; nuk kanë

vlerësuar pretendimin se për veprimet operative kishte informuar eprorët; nuk kanë provuar ekzistencën e një pasoje konkrete dhe të lidhjes shkakësore ndërmjet sjelljes së tij dhe pasojës dhe se disa nga rrethanat e përdorura për të mbështetur përgjegjësinë e tij penale kishin mbetur në nivelin e ideve ose mundësive hipotetike, sikurse përpjekja për vendosjen e pajisjeve gjurmuese, pa u materializuar në veprime konkrete; nuk kanë marrë në konsideratë provat shfajësuese, qëllimin e veprimeve të tij në funksion të luftës kundër trafikimit të lëndëve narkotike dhe faktin se sjelljet e kundërshtuara, edhe po të konsideroheshin të parregullta, mund të përbënin shkelje disiplinore, por jo domosdoshmërisht vepra penale. Po kështu, në lidhje me dënimin për veprën penale të moskallëzimit të krimit, kërkuesi ka argumentuar se fakti i identifikuar nga gjykatat nuk përmbushte elementet e figurës së veprës penale për të cilën ishte deklaruar fajtor. Në parashtrimet shtesë ai ka ngritur edhe pretendimin se procedimi penal ndaj tij ishte ndikuar nga deklaratimet publike të bëra në lidhje me veprimtari të dyshuara kriminale të funksionarëve të lartë.

41. Gjykata vëren se këto argumente, në thelb, nuk synojnë vetëm një rivlerësim të provave ose një interpretim të ndryshëm të ligjit të zakonshëm, por ato lidhen me respektimin e *së drejtës së mosdënimit pa ligj, parimin e prezumimit të pafajësisë, të drejtën e mbrojtjes dhe parimin e barazisë së armëve*. Për rrjedhojë, ato kanë natyrë kushtetuese dhe kërkojnë qëndrim të shprehur nga gjykatat e zakonshme. Ndërkohë, në vendimin e saj Gjykata e Lartë është mjaftuar të pohojë, në mënyrë të përgjithshme, se shkaqet e rekursit kishin marrë përgjigje në vendimin e gjykatës së apelit, se kjo e fundit kishte arsyetuar mjaftueshëm cilësimin juridik të fakteve dhe provueshmërinë e fajësisë dhe se nuk konstatoheshin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Megjithatë parashtrimet shtesë të kërkuesit janë evidentuar në pjesën hyrëse të vendimit, në arsyetimin e saj Gjykata e Lartë u është referuar shkaqeve të rekursit, ndërkohë që nuk gjendet asnjë përgjigje konkrete ose e tërthortë ndaj tyre.

42. Nisur nga sa më sipër, Gjykata rithekson se detyrimi për arsyetimin e vendimit gjyqësor nuk kërkon që gjykatat e zakonshme t'i përgjigjen në mënyrë të hollësishme çdo argumenti të palëve (*shih vendimet nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur në rekurs ngrihen pretendime thelbësore me natyrë kushtetuese, veçanërisht në një proces penal që ka përfunduar me dënim me burgim, gjykata më e lartë nuk mund të kufizohet në përdorimin e formulimeve të përgjithshme ose standarde. Ajo duhet të tregojë, së paku, se i ka identifikuar pretendimet, se i ka shqyrtuar në mënyrë reale dhe se ka vlerësuar nëse ato kërkonin ose jo shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore.

43. Konkretisht, Gjykata e Lartë duhej të shpjegonte përse nuk lidheshin me *të drejtën kushtetuese të mosdënimit pa ligj* pretendimet për mungesën e identifikimit të normës konkrete të shkelur në raport me përgjegjësinë hierarkike për sa u takon komunikimeve me eprorët për ndjekjen e ngjarjes kriminale (episodi i parë), si dhe pse veprimet me informatorin nuk përbënin krim, por kundërvajtje penale (episodi i katërt), çka do të zhbënte figurën e veprave penale të shpërdorimit të detyrës dhe moskallëzimit të krimit. Po kështu, ajo (Gjykata e Lartë) duhej të arsyetonte përse pretendimet për mungesën e ekzistencës së pasojës konkrete dhe lidhjes shkakësore ndërmjet sjelljes dhe pasojës (vendosja e pajisjeve gjurmuese) nuk ngrinin çështje që lidheshin me *parimin e prezumimit të pafajësisë* (episodi i tretë). Po në këtë drejtim, Gjykata e Lartë duhet të argumentonte se përse nuk lidhej me *të drejtën e mbrojtjes dhe parimin e barazisë së armëve* pretendimi për mosmarrjen në konsideratë të provave shfajësuese që lidheshin me rolin dhe kontributin e tij në parandalimin e kriminalitetit (episodi i dytë). Gjithashtu, pretendimi i kërkuesit se ai ka vepruar në kontekstin e zhvillimeve politike të tilla, që më pas rezultuan me shkarkimin dhe dënimin e një funksionari të lartë publik, ishte i tillë që kërkonte një vlerësim të kujdesshëm nga Gjykata e Lartë, me qëllim garantimin e besimit publik te sistemi i drejtësisë, për

aq sa ky pretendim lidhet me *të drejtën e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe parimin e prezumimit të pafajësisë*. Argumentimi se pretendimet e kërkuarit kishin marrë përgjigje nga gjykata e apelit nuk e përjashton Gjykatën e Lartë nga detyrimi për të verifikuar nëse përgjigjet ishin në përputhje me standardet kushtetuese. Në kuadër të parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të të drejtave kushtetuese nga gjykatat e faktit përbën funksion edhe të Gjykatës së Lartë. Referimi i përgjithshëm tek arsyetimi i gjykatës së apelit, pa identifikuar pretendimet kushtetuese dhe pa shpjeguar përse ato nuk përbënin shkaqe rekursi, nuk përmbush këtë funksion kushtetues të saj.

44. Gjykata çmon se arsyetimi i përdorur në vendimin e mospranimit nuk bën të mundur të kuptohet nëse Gjykata e Lartë ka shqyrtuar realisht pretendimet e kërkuarit dhe, në veçanti, ato të paraqitura në parashtrimet shtesë. Ndonëse procedura e shqyrtimit paraprak të rekursit mund të realizohet mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë e palëve, kjo nuk e përjashton detyrimin e Gjykatës së Lartë për të dhënë një përgjigje të kuptueshme dhe të kontrollueshme. Shqyrtimi *de plano* nuk mund të reduktohet në një formalitet procedural, veçanërisht kur rekursi ngre çështje që lidhen drejtpërdrejt me ligjshmërinë e dënimit penal dhe me respektimin e garancive themelore të procesit.

45. Në këto rrethana, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i mundëson kërkuarit të kuptojë arsytet përse pretendimet e tij me natyrë kushtetuese nuk janë pranuar dhe as Gjykatës të ushtrojë kontroll efektiv mbi mënyrën sesi ato janë shqyrtuar. Përgjigja formale dhe stereotipe e ka reduktuar rekursin në një hap procedural dhe e ka bërë aksesin e kërkuarit në Gjykatën e Lartë vetëm formal dhe jo efektiv. Megjithatë, ky konstatim nuk nënkupton vlerësim të fajësisë ose pafajësisë së kërkuarit dhe as rivlerësim të provave të administruara nga gjykatat e zakonshme. Gjithashtu, Gjykata nuk paragjykon mënyrën se si Gjykata e Lartë duhet t'u përgjigjet në themel pretendimeve të ngritura. Detyra e juridiksionit kushtetues kufizohet në verifikimin nëse kërkuarit i është garantuar një shqyrtim real dhe një përgjigje e arsyetuar ndaj pretendimeve të tij me natyrë kushtetuese.

46. Për sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se mospranimi i rekursit pa një arsyetim shterues për pretendimet me natyrë kushtetuese, përfshirë ato të paraqitura në parashtrimet shtesë, nuk përmbush standardin kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe e ka bërë aksesin e kërkuarit në Gjykatën e Lartë formal dhe jo substancial. Për rrjedhojë, kërkuarit i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e *së drejtës së aksesit substancial në gjykatë dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*.

C. Për shpenzimet e përfaqësimit

47. Në objektin e ankimit kushtetues individual kërkuari ka kërkuar edhe rimbursimin e shpenzimet gjyqësore të përfaqësimit para Gjykatës, por pa i bashkëlidhur kërkesës ndonjë provë lidhur me shpenzimet e kryera. Në datën 12.1.2026, përfaqësuesi i kërkuarit ka paraqitur parashtrimet shtesë, bashkëlidhur të cilave ka dërguar edhe faturën tatimore të lëshuar në datën 10.1.2026, në vlerë 200.000 lekë, me përshkrimin "*Përfaqësimi Dritan Zagani në Gjykatën Kushtetuese*".

48. Neni 28 i Ligjit Organik ka parashikuar rregullat për sa u takon shpenzimeve gjyqësore, sipas të cilave, shpenzimet e procesit gjyqësor përpara saj u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifën gjyqësore (*pika 1*); kur vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, ajo mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuari (*pika 2*). Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas së cilit me paraqitjen e kërkesës paraqitet edhe akti që provon shlyerjen e tarifave përkatëse (*pika 2*); kur vendoset pranimi i ankimit kushtetues

individual, Gjykata shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (pika 4).

49. Gjykata ka pohuar se individi ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërteton se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe në masë të arsyeshme, ndaj ai duhet të paraqesë edhe aktet që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të kërkuesit, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar (*shih vendimet nr. 57, datë 14.10.2025; nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi është përfaqësuar nga i njëjti avokat që në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual fillestar (1.8.2025). Pasi çështja ka kaluar në seancë plenare dhe kërkuesi është njoftuar për prapësimet e paraqitura nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuesi i tij ligjor, në datën 12.1.2026, ka paraqitur së bashku me parashtimet shtesë edhe faturën tatimore të lëshuar në datën 10.1.2026, në vlerën 200.000 lekë, por pa parashtuar ndonjë argument mbështetës për këtë kërkim.

51. Për sa më lart, Gjykata çmon se kerkimi i kërkuesit për shpenzimet gjyqësore është paraqitur brenda afatit, pasi ai është depozituar përpara marrjes së vendimit për pranimin e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me masën, Gjykata, duke marrë në konsideratë faktin se, nga njëra anë, kërkuesi nuk ka parashtuar ndonjë argument mbështetës lidhur me vlerën e kërkuar të shpenzimeve gjyqësore dhe, nga ana tjetër, se gjykimi kushtetues është zhvilluar mbi bazë të dokumenteve, por çështja e kërkuesit ka qenë komplekse, i vlerëson shpenzimet e përfaqësimit në vlerën 75.000 lekë. Gjithashtu, në kushtet kur në gjykimin kushtetues individi kërkon të mbrojë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, ndaj përgjegjësia i takon vetë shtetit (*shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata çmon se detyrimi për pagimin e shpenzimeve të përfaqësimit duhet t'i ngarkohet Ministrisë së Financave.

52. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit janë të bazuara sipas arsytimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-277, datë 18.2.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
4. Shpenzimet e përfaqësimit të kërkuesit në vlerën 75.000 lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.6.2026.

Shpallur më 21.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Asim
Vokshi, Marjana Semini